

# DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

## BULETINI INFORMATIV




KORRIK 2023



Prej datës 01.07.2023 Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore, në Tropojë dhe Përmet janë funksionale;



Si dhe është finalizuar hapja e 4 Qendrave të tjera të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore në qytetin e Matit, Pukës, Kurbinit dhe Kavajës, në ambientet e ish-gjykatave të mbylluara nga implementimi i Hartës së Re Gjyqësore.



Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas mori pjesë në konferencën finale të projektit "Rritja e aksesit të barabartë të minoritetit Rom në të drejtat publike dhe civile", organizuar nga Shoqata Romano Kham, në kuadër të projektit "Rritja e aksesit të barabartë të minoritetit rom në të drejtat publike dhe civile" në kontekstin e projektit "Zgjerimi i Shërbimeve të Ndihmës Juridike Falas për Gratë dhe Burrat në Shqipëri" (EFLAS) i financuar nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim (ADC) dhe zbatuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP Albania) në partneritet me Ministria e Drejtesise.

**Në të gjithë territorin e Shqipërisë, tashme funksionojnë 20 Qendra të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore, 12 prej tyre të financuara nga buxheti i Shtetit.**

Në datën 07.07.2023, Z.Ergys Qirici, Drejtori i Përgjithshëm, i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas mori pjesë në aktivitetin e zhvilluar në kuadër të Ditës Kombëtare të Ndërmjetësimit. në ambientet e Ministrisë së Drejtesisë.



# Në kuadër të informimit & ndërgjegjësimit të personave të cilëve u është cënuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore u angazhuan në zhvillimin e aktiviteteve dhe takimeve përgjatë muajit Korrik 2023

## Kukës

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Kukës ka zhvilluar një takim pranë ambienteve të zyrës me individë të kategorisë të të cilëve është cënuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, duke diskutuar dhe analizuar problematikën që kanë hasur në përditshmërinë e tyre. Pjesëmarrësit gjatë takimit u informuan rreth funksionimit të Qendrës, shërbimeve që ofrohen si dhe u informuan mbi Ligjin nr.111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti".




## Durrës

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Durrës, në bashkëpunim me Qendrën Multifunktionale Nishtulla dhe me përfaqësues të shoqatës së romëve dhe egjiptianëve zhvilloi në datën 03.07.2023 një takim me viktimat e diskriminimit për shkak të përkatësisë etnike. Gjatë këtij takimi qytetarët, viktimat të diskriminimit, shprehen se ndjehen të diskriminuar në punësim, në shkollë, madje edhe në ambiente të ndryshme publike, etj. Forma e diskriminimit më e përhapur sipas tyre është punësimi. Ata shprehen se nuk i pranojnë në punë për shkak të përkatësisë etnike.

## Fier

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Fier zhvilloi takimin në bashkëpunim me përfaqësuesen e Zyrës Rajonale të Komisioneres për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pranë ambienteve të zyrës. Qytetarët e pranishëm ishin në profesion mësues për Arsimin Parashkollor, të cilët ishin paraqitur pranë KMD, ku kishin kërkuar parashtruar problematikën në lidhje me ndryshimin e nivelit të pagës, në bazë të VKM NR.175, datë 08.03.2017, e cila ne qytetin ku ishin të punësuar interpretohej ndryshe nga qytetet e tjera.



## Vlorë



Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Vlorë, në datën 06.07.2023 zhvilloi një takim me "Personat të cilëve u është cënuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent", si një prej kategorive të veçanta përfituese referuar ligjit nr.111/2017.

## Elbasan

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Elbasan, në datën 05.07.2023 zhvilloi një aktivitet në zona të ndryshme të qytetit, ku qytetarët u informuan se një kategori përfituese e ligjit, janë personat të cilët u është cënuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.





# Në kuadër të informimit & ndërgjegjësimit të personave të cilëve u është cënuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore u angazhuan në zhvillimin e aktiviteteve dhe takimeve përgjatë muajit Korrik 2023

## Pogradec

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Pogradec, në bashkëpunim me përfaqësuesen e Komisionerit të Diskriminimit/Zyra Rajonale Korçë, zj.Eva Tare, zhvilloi takimin me banorët e godinës së ish minieres Guri i Kuq, përsa i përket trajtimit të çështjes, ku në fokus janë personat të cilëve u është cënuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi. Banorët që jetojnë në godinën e ish minierës të Gurit të Kuq, e cila ndodhet në periferi të qytetit, kanë iniciuar proces gjyqësor, duke qënë të diskriminuar për shkak se godina do të shitej në ankand dhe në këtë mënyrë nuk mund t'iu sigurohej e drejta e banesës. Ky proces ndiqet nga Komisioneri i Diskriminimit.



## Gjirokastrë

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Gjirokastrë, në datën 05.07.2023 zhvilloi aktivitetin ndërgjegjësues dhe informues pranë Qendrës, për trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, në bashkëpunim me nënpunësat e barazisë gjinore, Bashkia Gjirokastrë, si dhe me pjesëmarrjen e qytetarëve, kryetare e PAK. Në qytetin e Gjirokastrës nuk ka patur raste diskriminimi, të cilat të jenë trajtuar nga nënpunësja e barazisë gjinore, Bashkia Gjirokastrë.



## Lushnjë

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Lushnjë, në datën 07.07.2023 me pjesëmarrjen e prindërve të fëmijëve invalide, zhvilloi një aktivitet informues, për rastet kur cënohet e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi. Në këtë aktivitet pjesëmarrësit u informuan se një kategori përfituese e ligjit, janë personat të cilët u është cënuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.



## Dibër

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Diber, zhvilloi një takim me përfaqësuesin e Ndhmës

Ekonomike, Z. Ardit Hoxha dhe specialistët e Bashkisë Dibër, duke u fokusuar te trajtimi i temës për kategorinë e veçantë përfituese e ligjit, që janë personat që i'u është cënuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi. që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.



Në kuadër të informimit & ndërgjegjësimit të personave të cilëve u është cënuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore u angazhuan në zhvillimin e aktiviteteve dhe takimeve përgjatë muajit Korrik 2023

## Lezhë

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Lezhë zhvilloi në datën 07.07.2023, një takim me qytetarë, të cilët me parë kanë parashtruar pranë kësaj Qendre problematikat e tyre. U evidentua rasti i zonjës Sh.L., e cila jeton e vetme pasi ka mbetur e ve, nuk ka femijë dhe banesa e saj është dëmtuar nga tërmeti. Ajo pretendon që Bashkia Lezhë nuk po i rindërton banesën e saj, në krahasim me rindertimet e qytetareve të tjerë në Qytetin e Lezhës.



## Shkodër



Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Shkodër zhvilloi në datën 04.07.2023, një takim me personat të cilëve u është cënuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen ngadiskriminimi si një prej kategorive të veçanta përfituese referuar ligjit 111/2017. Takimi u zhvillua pranë Bashkisë Shkodër, në ambientet e KMD, me praninë e përfaqesues për Shkodren znj.Filomena Bujarja.




## Tiranë

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Tiranë zhvilloi në datën 06.07.2023, një takim dhe asistim ligjor falas me zj. M.Ll dhe M.R, të cilat janë larguar nga puna për arsye diskriminimi (moshës). Zonjat janë asistuar me ndihmë juridike parësore dhe dytësore, me qëllim dërgimin e çështjeve respektive në Gjykatë.

## Korçë



Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Korçë zhvilloi në datën 03.07.2023, një aktivitet me personat të cilëve u është cënuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi, si një prej kategorive të veçanta përfituese referuar ligjit 111/2017. Në takim u diskutuan mbi çështje për të cilat ata kanë hasur vështiresi, ku problematika kryesore ishin çështjet e strehimit, ndihma ekonomike, rregjistrimi i femijëve si dhe përfitimi i bursave të shkollës.



## Berat

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Berat zhvilloi në datën 03.07.2023, një takim me personat të cilëve u është cënuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi si një prej kategorive të veçanta përfituese referuar ligjit Nr. 111/2017.



# Në kuadër të informimit & ndërgjegjësimimit të personave që përfitojnë nga Skemat e Mbrojtjes Sociale

## Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore u angazhuan në zhvillimin e aktiviteteve dhe takimeve përgjatë muajit Korrik 2023

### Durrës

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Durrës, në datën 17.07.2023 zhvilloi një takim me të moshuarit që përfitojnë shërbime nga Qendra e të Moshuarve Durrës, si pjesë e kategorive përfituese nga skemat sociale. Gjatë këtij takimi të moshuarit shprehën problematikat e tyre, të cilat lidheshin kryesisht me të ardhurat e pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet jetike si ushqimi dhe ilacet.



### Korçë

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Korçë, në datën 14.07.2023 zhvilloi një takim me

personat të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale, si një prej kategorive të veçanta përfituese referuar shkronjës gj) të nenit 11 të ligjit 111/2017.



### Fier

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Fier, në datën 18.07.2023 zhvilloi një takim, në bashkëpunim me përfaqësues të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Fier, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social dhe Qendës së Fëmijeve me Aftësi Ndryshe, në Bashkinë Fier dhe përfaqësuesen e KMD. Ky takim u zhvillua në kuadër të informimit dhe ndërgjegjësimimit për personat të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale, si një prej kategorive të veçanta përfituese.

### Vlorë

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Vlorë, në datën 18.07.2023 zhvilloi një takim, pranë Zyrës Rajonale të Shërbimit Social Vlorë, ku morën pjesë përfaqësuesja znj. Elisabeta Merkohitaj, personat të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale, si një prej



kategorive të veçanta përfituese referuar shkronjës gj) të nenit 11 të ligjit 111/2017, si dhe me përfaqësueset e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, zj. S.Qevani, zj. L.Lite dhe zj. K.Poci.



### Tiranë

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Tiranë, në datën 20.07.2023 zhvilloi një aktivitet informues dhe asistues me persona që përfitojnë nga skema e mbrojtjes sociale, në ambjentet e pritjes me publikun në Ministrinë e Drejtësisë.



### Pogradec

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Pogradec, në datën 18.07.2023 zhvilloi një takim me personat të cilët përfitojnë nga skemat e mbrojtjes sociale, në sallën e Këshillit Bashkiak, ku pjesëmarrës ishte dhe përfaqësuesja e zyrës rajonale, avokati i popullit Pogradec. Në këtë takim pjesëmarrësit u informuan mbi Ligjin Nr.111/2017 "Për Ndhmë Juridike të Garantuar nga Shteti" si dhe shërbimet që ofron Qendra Pogradec.





# Në kuadër të informimit & ndërgjegjësimit të personave që përfitojnë nga Skemat e Mbrojtjes Sociale

## Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore u angazhuan në zhvillimin e aktiviteteve dhe takimeve përgjatë muajit Korrik 2023

### Elbasan

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Elbasan, në datën 21.07.2023 zhvilloi një takim informues dhe ndërgjegjësues me personat të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale, pranë Qendrës Sociale "Buka e Jetës" me vendodhje në Elbasan, e cila është një qendër e strehimit ditor të personave duke filluar nga mosha 16 vjecare.



### Lezhë

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Lezhë, në datën 28.07.2023 zhvilloi një aktivitet me personat të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes

### Berat

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Berat, në datën 25.07.2023 zhvilloi një aktivitet me personat të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale.



sociale. Gjatë këtij aktiviteti u evidentua rasti i z. P.L.



### Gjirokastrë

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Gjirokastrë, në datën 25.07.2023 zhvilloi një aktivitet pranë rezidencës sociale "Shtëpia e të moshuarve", Gjirokastrë.



Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Lushnjë, në datën 20.07.2023 zhvilloi një aktivitet në ambientet e Bashkisë Lushnjë. Në këtë aktivitet morën pjesë stafi i drejtorisë së shërbimit social, si dhe fondacioni Mary Word Loreto.

### Lushnjë



### Dibër

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Dibër, në datën 24.07.2023 zhvilloi një aktivitet me personat të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale.




Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Shkodër zhvilloi një takim me përgjegjësën e shërbimit social pranë Bashkisë Shkodër (sektori i Ndhmës Ekonomike) për personat të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale.

### Shkodër

### Kukës

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Kukës, zhvilloi një aktivitet me personat të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale, pranë ambienteve të Drejtorisë së Shërbimit Social, Bashkia Kukës.





## Dibër

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Dibër, në bashkëpunim me Organizatën "Të Ndryshëm & Të Barabartë" (D&E) zhvilloi një aktivitet në kuadër të projektit të D&E "Rritja e kapaciteteve për ofrimin e ndihmës juridike falas për viktimat e krimit dhe individë të tjerë vulnerabël nëpërmjet fuqizimit të profesionistëve të ligjit dhe avokatisë "probono", si pjesë e Projektit "Zgjerimi i shërbimit të ndihmës juridike falas për gratë dhe burrat në Shqipëri".



## Lezhë

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Lezhë ka zhvilluar një takim informues me komunitetin për zgjidhjen e konflikteve, me anë të Ndërmjetësimit. Në këtë takim të organizuar nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësimit morën pjesë

Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësimit, Drejtoria e Shërbimit dhe e Kujdesit Social, Fondacioni Mary Ward Loretto.



## Dibër

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Dibër zhvilloi një takim me përfaqësuesen e Osce Odir zj. Viola, si kordinatore për të drejtat e njeriut.



## Fier

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Fier, në bashkëpunim me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi realizoi një aktivitetit

për personat me aftësi ndryshe si një prej kategorive të veçanta përfituese referuar ligjit 111/2017, në ambjentet e Qendrës Multifunkionale Horizont, me drejtorin dhe përfaqësuesen e shërbimit social të qendrës.



## Lezhë

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Lezhë ka zhvilluar një takim, në bashkëpunim me Organizatën të Ndryshëm e të Barabartë, me temë "Sfidat mundësitë për ofrimin e ndihmës juridike falas për viktimat e krimit". Në këtë takim morën pjesë Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social, Bashkia Lezhë, Dhoma Vendore e Avokatisë, prokuroria dhe Drejtoria Arsimore.



## Tropojë

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Tropojë, në bashkëpunim me Bashkinë Tropojë, zhvilloi një takim me përfaqësues nga Njësitë Administrative, Komisionari i Policisë dhe specialistë të ndihmës ekonomike dhe shërbimit social pranë Bashkisë Tropojë.



## Përmet

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Përmet, në bashkëpunim me Bashkinë Përmet zhvilloi një takim informues dhe

sensibilizues me përfaqësues të Bashkisë Përmet të sektorëve si më poshtë: Shërbimi Social, Dhuna në familje, Ndhma ekonomike dhe PAK, Qendra e fëmijëve me aftësi të veçanta, kordinatorët e dhunës në familje, sektori juridik, zyra me një ndalesë One Stop Shop si dhe administratorët shoqëror.



## Dibër

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Dibër zhvilloi një takim me personat me aftësi të kufizuar, si një nga kategoritë përfituese të ligjit.





## Kukës

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Kukës, në datën 10.07.2023, në bashkëpunim me Organizatën "Të Ndryshëm & Të Barabartë", zhvilloi një takim me pjesëmarrjen e qytetarëve.



## Lushnjë

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Lushnjë, në datën 18.07.2023, mori pjesë në një aktivitet i zhvilluar pranë Bashkisë Lushnjë.



Në këtë aktivitet mori pjesë organizata "Nisma ligjore", dhe institucione të tjera, si Ishp, përmbarami Policia, etj.

## Kukës

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Kukës, në datën 10.07.2023, mori pjesë në trajnimin me temë "Ndhma Juridike Për Sigurimin e Aksesit në Drejtësi për Grupet Vulnerabël", organizuar nga Qendra Europiane.



## Fier

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Fier, në datën 26.07.2023, ka marrë pjesë në një aktivitet të zhvilluar nga shoqata Rromano Kham, në fshatin Sektor Seman dhe Baltëz Fier, i cili kishte për qëllim njohjen dhe krijimin e urave të bashkëpunimit midis qytetarëve romë me institucionin e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.



## Kukës

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Kukës, në datën 14.07.2023, mori pjesë në Forumin e Diskutimit "Krijimi i urave për rrjetëzim dhe bashkëpunim midis OSHC-ve, qytetarëve dhe aktorëve të interesit në luftën kundër korrupsionit, forcimit të shtetit të drejtës dhe mirëqeverisjes!"



Në datën 21.07.2023, Z.Ergys Qirici, Drejtori i Përgjithshëm, i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas mori pjesë në takimin e zhvilluar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, ku morën pjesë avokatë të Dhomës Vendore të Avokatisë, si dhe përfaqësues nga pushteti lokal.